



Znj. Alma Kondi është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë për Informatikë Ekonomike në vitin 2007, ndërsa në vitin 2014 ka përmbyllur me sukses Masterin Profesional në Manaxhim Biznesi, pranë po këtij Fakulteti.

Prej vitit 2009, ka ushtruar detyra të ndryshme në Institutin e Statistikave, e angazhuar në nivele të ndryshme fillimisht si Specialist në Sektorin e Metodologjisë, më pas si Përgjegjëse në Sektorin e Metodologjisë së Statistikave Sociale, për të vazhduar më tej në Sektorin e Cilësisë dhe Metadatave.

Znj. Alma Kondi gëzon një ekspertizë të çertifikuar nga institute të specializuara ndërkombëtare në fushën: e manaxhimit të cilësisë dhe metadatave, infrastrukturës teknologjike, implementimin e metodave inovative për mbledhjen dhe analizimin e thelluar të të dhënave, si dhe aplikimin e metodologjive të ndryshme për zhvillimin e aktiviteteve statistikore.

Znj. Kondi ka kontribuar si autore apo bashkëautore në studime të rëndësishme në fushat e statistikës dhe ekonomisë si dhe është antare e bordit editorial së Revistës Shkencore KËRKIMI dhe Revistës informative INFOSTAT.

Nga Qershori i vitit 2019, mban detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave.